



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. 21676 prot.

Shkodër, me 23.12.2025

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt-vendimin **“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 76 DATË 19.12.2024 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2025 - 2027 TË BASHKISË SHKODËR”, I NDRYSHUAR.**

Duke ju uruar punë të mbarë.

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr _____ prot.

Shkodër, me _____.____.2025

PROJEKT-VENDIMI

Nr. _____, datë _____.____.2025

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 76 DATË 19.12.2024 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2025 - 2027 TË BASHKISË SHKODËR”, I NDRYSHUAR

Këshilli i Bashkisë Shkodër, sot me datë ____/____/2025, në mbështetje të nenit 40, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar; VKB nr. 15 datë 20.7.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare Bio Strajca sh.a, si person juridik në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”, VKB nr. 28 datë 29.5.2025 “Për dhënie pëlqimi, shtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare “Bio Strajca”, në pronësi të Bashkisë Shkodër; ligjit nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, datë 03.12.2024; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar, sipas materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë me propozim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër me nr. _____ Prot datë _____, _____, 2025,

V E N D O S I

1. Miratimin e ndryshimit në buxhetin e miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar, programi AC141 Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural, fisha P.AC141.Q2.O1.A1 Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese, sipas fishës bashkëngjitur, si më poshtë:

- Pakësimi

Institucioni	Pr.	Pakësim në lekë	2025	
		Emërtimi i Aktivitetit	Investime 231	Totali 2025
Bashkia Shkodër	AC141	PAC141(04220).Q2.O1.A1 Trajtimi i qenve të rrugës (Shtesë) - e trashëguar Nënaktiviteti A3 Ndërtim i strehëzës së re të qenëve dhe Rrethim oborri strehëza e qenëve dhe kolibe për qen – zbatim	690,000	690,000
TOTALI			690,000	690,000

- Shtesa

Institucioni	Pr.	Shtesa në lekë	2025	
		Emërtimi i Aktivitetit	Transferta	Totali 2025
Bashkia Shkodër	AC141	P.AC141.Q2.O1.A1 Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese (Shtesë) A.4 Mbështetje financiare për Sh.a. Skodrinon, për Tregun Rus	690,000	690,000
TOTALI			690,000	690,000

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet Beci

Zv. Kryetar

Alban Peci

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

Blum. Neru

Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor

Georgi Haxo
Paqepulsi e fider

Drejtoria e Financës

Blendi Myrtaq

Drejtoria e Juridike

Drejtoria Planifikimit Strategjik dhe
Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Stela Mardules

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit
Financiar

Drejtoria e Përgjithshme e Juridike,
Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve
Mbështetëse

ELVIN DRAHIMI

G. Daut

Skodrinon Sh.a.

Arleta Peliç

Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
Trajtimit të AMTP

P/ Enton Dedo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot.

Shkodër, më _____. _____. 2025

RELACION

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 76 DATË 19.12.2024 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2025 - 2027 TË BASHKISË SHKODËR”, I NDRYSHUAR”

Merkata e Rusit është tregu kryesor i Bashkisë Shkodër i cili është financuar në bashkëpunim me AZHBR dhe funksionon si treg publik përmes menaxhimit nga Sh.a. Skodrinon. Rikualifikimi i këtij tregu, sipas VKM nr.125, datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2023”, ka pasur si qëllim jo vetëm rikonstruksionin e Merkatës së Rusit, por edhe arritjen e krijimit të Sh.a. për menaxhim të tregjeve dhe bërjen të qëndrueshme nga ana financiare të menaxhimit të këtij tregu.

Bashkia Shkodër ka në zbatim VKB nr. 1, datë 22.01.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar, në të cilën janë të përcaktuara edhe tarifat e vendosura për përdorim të banakëve të tregtimit. Kjo tarifë, prej 7,000 lek për banak, ka reflektuar të gjitha shpenzimet e parashikuara mujore dhe vjetore si dhe kostot e shpenzimit duke parashikuar një marzh fitimi vjetor në vlerën prej 900,000 – 1.000,000 lekësh e cila do të përdorej për mirëmbajtjen e vazhdueshme të tregut, por edhe si kapital për krijimin e mundësisë për investime të reja në krijim të hapsirave të tregtimit për prodhimet lokale.

Në vijim të procesit të menaxhimit të tregut të Rusit, Sh.a. Skodrinon ka një plan të ardhurash prej 9,660,000 lekësh për sa i përket dhënies në përdorim të banakëve të tregut.

Situata ekzistuese e planit vjetor të të ardhurave

Kapaciteti Maksimal	115
Tarifa aktuale/muaj	7,000
Muaj	12
Të ardhurat totale	9,660,000

Ndërkohë shpenzimet për një vit ushtrimor, konkretisht për vitin 2025 janë të planifikuara në vlerën 8,731,112 lekë në vit.

SHPENZIME VITI 2025	
PAGA DHE SIGURIME	Realizimi i pritshëm

Total I	2,199,072
UJË, DRITA, INTERNET	Realizimi i pritshëm
Total II	1,482,040
MIRËMBAJTJE DHE RIPARIME	Realizimi i pritshëm
TOTAL III	550,000
KTHIM INVESTIMI VJETOR	Realizimi i pritshëm
Total IV	4,500,000
TOTAL SHPENZIME VJETORE TREGU RUS	8,731,112

Referuar punës së bërë nga Skodrinon sh.a. për lidhjen e kontratave me tregtarët e Merkatës Rus, si dhe mbi bazën e diskutimeve dhe konsultimeve me tregtarët e këtij tregu, vërehet rezistencë sa i përket lidhjes së kontratave të reja dhe vijim të pagesës së tarifës ekzistuese, e cila ka synim të ndërtojë një mekanizëm i cili ndihmon në arritjen e qendrueshmërisë me qëllim realizimin e aktiviteteve për të cilat Skodrinon sh.a. funksionon.

Duke marrë parasysh edhe problematikën e shprehur nga tregtarët e Rusit në lidhje me tarifën ekzistuese, megjithëse është një tarifë e cila reflekton kostot e mirëmbajtjes dhe administrimit të këtij tregu, si dhe shkresën nr. 20952 prot. datë 16.10.2025 të Skodrinon Sh.A., propozojmë që të kemi një mbështetje financiare të kësaj tarife, në favor të tregtarëve të Tregut Rus.

Ky propozim vjen në kuadër të nevojës për mbështetje të funksionimit të këtij tregu në mënyrë të qëndrueshme si dhe mbështetje të tregtarëve të tregut Rus të cilët tregtojnë produktet lokale dhe nxisin zhvillimin ekonomik të zonave tona rurale, përmes krijimit të mundësisë së tregtimit të këtyre produkteve.

Në vijim të takimeve të realizuara me tregtarët e Rusit sipas shprehjes së problematikës nga ana e tyre propozohet që tarifa të vijojë të jetë 7,000 lek për banak, ku tregtarët të paguajnë vlerën 4,000 lek në muaj, ndërsa Bashkia Shkodër të bëjë një mbështetje financiare për këto tregtarë në vlerën 3,000 lek në muaj nga momenti i miratimit në Këshill Bashkiak deri në fund të vitit 2026.

Plani vjetor i të ardhurave i rishikuar për tregtarët

Kapaciteti maksimal	115
Tarifa /muaj	4,000
Muaj	12
Të ardhurat totale	5,520,000

Plani vjetor i mbështetjes financiare nga bashkia Shkodër

Kapaciteti maksimal	115
Tarifa /muaj	3,000
Muaj	12
Te ardhurat totale	4,140,000

Plani mujor i mbështetjes financiare nga Bashkia Shkodër

Kapaciteti maksimal	115
Tarifa /muaj	3,000
Muaj	1
Te ardhurat totale	345,000

Kjo vendimarrje do të bëjë të mundur që planifikimi i të ardhurave për Sh.a Skodrinon të mos ndryshojë duke mos cënuar as shpenzimet e planifikuara me synimin e krijimit të një sh.a. të qëndrueshme nga ana organizative dhe financiare.

Konkretisht për muajt nëntor – dhjetor 2025 propozohet që të ketë një mbështetje financiare nga Bashkia Shkodër në vlerën – 690,000 lekë

Ndërsa në vitin 2026 një mbështetje financiare prej 4,140,000 lekë

Mbështetje financiare për sh.a. Skodrinon dhe transfertat e shumës përkatëse do të realizohet pas akt-rakordimeve me Sh.a. sa i përket numrit të kontratave ekzistuese dhe kërkesës nga ana e Skodrinon sh.a. për transferim të fondit.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 40, të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar; VKB nr. 15 datë 20.7.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare Bio Strajca sh.a, si person juridik në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratimin e aktit të themelimit dhe statutit”, VKB nr. 28 date 29.5.2025 “Për dhënie pëlqimi, shtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare “Bio Strajca”, në pronësi të Bashkisë Shkodër; ligjit nr.115/2024 ”Për buxhetin e vitit 2025”, i ndryshuar, datë 03.12.2024; Udhëzimit Plotësues të Ministrisë së Financave nr.2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, VKB nr.76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë së Shkodrës”, të ndryshuar, paraqitet si më poshtë vijon ndryshimi:

- Pakësimi

Institucioni	Pr.	Emërtimi i Aktivitetit	Pakësim në lekë	
			Investime 231	2025 Totali 2025
Bashkia Shkodër	AC141	PAC141(04220).Q2.O1.A1 Trajtimi i qenve të rrugës (Shtesë) - e trashëguar Nën/aktiviteti A3 Ndërtim i strehëzës së re të qenëve dhe Rrethim oborri strehëza e qenëve dhe kolibe për qen – zbatim	690,000	690,000

		TOTALI	690,000	690,000
--	--	---------------	----------------	----------------

- Shtesa

		Shtesa në lekë	2025	
Institucioni	Pr.	Emërtimi i Aktivitetit	Transferta	Totali 2025
Bashkia Shkodër	AC141	P.AC141.Q2.O1.A1 Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese A.4 Mbështetje financiare për Sh.a. Skodrinon, për Tregun Rus	690,000	690,000
		TOTALI	690,000	690,000

Duke ju falenderuar!

Zv/Kryetar

Alban Reke



Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik

Bakim Reme

Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit

Sela Mardusha

Skodrinon Sh.A

Adeta Pehinaku

Drejtorja e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP

P/Enton Dedogj

Nr.9	P.AC141.Q2.O1.A1 Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese (Shtesë)	Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural						
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:								
i. Situata								
Në Tregun e Rusit, i cili menaxhohet nga Sh.a. Skodrinon, në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74, datë 19/12/2023, me një kapacitet prej 115 vendesh tregtimi, ushtrojnë veprimtarinë e tyre tregtarë lokalë, të cilët operojnë kryesisht në fushën e produkteve ushqimore dhe bujqësore. Shoqëria "Skodrinon" sh.a., në funksion të menaxhimit të këtij tregu, ka ndërmarrë procesin e lidhjes së kontratave me tregtarët dhe aplikimin e një tarife që mbulon kostot e mirëmbajtjes dhe administrimit të tregut. Por, gjatë konsultimeve me tregtarët është evidentuar rezistencë ndaj tarifës aktuale dhe vështirësi në përballimin e saj nga tregtarët. Ndodhur në këto kushte, shoqëria "Skodrinon" sh.a., propozon ofrimin e ndihmesës në lehtësimin e barrës financiare që lidhet me tarifën mujore të përdorimit të hapësirave tregtare (banakëve), me qëllim nxitjen e formalizimit, vijimësinë e aktivitetit tregtar dhe garantimin e mirëmbajtjes së qëndrueshme të tregut, më poshtë vijon: - Tarifa mujore për përdorimin e një banaku në Tregun "Rusi" përcaktohet në vlerën 7,000 lekë/muaj. - Tregtarët do të paguajnë një pagesë mujore prej 4,000 lekë për banak. - Bashkia Shkodër, nëpërmjet mbështetjes financiare, do të mbulojë diferencën prej 3,000 lekë për banak në muaj, në funksion të lehtësimit të kostove për tregtarët Bashkia Shkodër synon përmirësimin e kushteve të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike për tregtarët lokalë dhe për të në ndërtuar një mekanizmi të qëndrueshëm administrimi dhe mbështetjeje për tregtarët lokalë. Zbatimi i kësaj politike do të realizohet në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke rakorduar transferimin e shumës, sipas numrit të kontratave të lidhura, në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe shoqërisë "Skodrinon" sh.a., duke u orientuar drejt interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik lokal.								
ii. Synimi i projektit								
Mbështetje e funksionimit të tregut Rus në mënyrë të qëndrueshme si dhe mbështetje të tregtarëve të tregut Rus të cilët tregtojnë produktet lokale dhe nxisin zhvillimin ekonomik të zonave tona rurale.								
iii. Aktivitetet kryesore të projektit								
1. Mbështetje financiare për mbulimin e pjesshëm të tarifës mujore për përdorimin e hapësirave tregtare, bazuar në numrin e kontratave të lidhura me tregtarët në Tregun "Rusi".								
b) Rezultatet që prisni								
1. Tregje operative që përmbushin standardet dhe sigurojnë kushte të përshtatshme për veprimtari tregtare te favorshme. 2. Rritje e formalizimit të tregtarëve lokalë, si rrjedhojë e uljes së barrës financiare dhe nxitjes për pjesëmarrje në skema të rregullta kontraktuale. 3. Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm përmes ruajtjes dhe nxitjes së zinxhirit të furnizimit me produkte lokale bujqësore dhe ushqimore.								
c)Aktorët e mundshëm				d)Kontributet e mundshme në projekt				
Bashkia Shkodër Tregtarët e Tregut Rus				Bashkia shkodër, Skodrinon Sh.a.				
e) Shpenzimet e llogaritura								
Shpenzimet për çdo aktivitet 2025				Totali (mijë lekë)	Nga kjo:			
				Paga	Sigurime	Operative	Transferime	Kapitale
A.1	Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrueshmërinë e kushteve të tregtimit							
A.2	Pagesat e shërbimeve me te trete (energji elektrike dhe uje.							

A.3	Instalimi i 15 matësve individual për përdoruesit e njësive tregtare Tregu i Shumicës Fruta – Perime Sh.a.						
A.4	Mbështetje financiare për Sh.a. Skodrinon, për Tregun Rus	690				690	
	Shuma	690				690	
f) Periudha e zbatimit 2025		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Drejtoria e Planifikimit strategjik dhe e përmirësimit të Klimës së biznesit Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër					